REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
GJIMNAZI "PERIKLI IKONOMI" FIER

PLANI VJETOR
I GJIMNAZIT "PERIKLI IKONOMI"

PËR VITIN SHKOLLOR 2026-2027

PROCEDURA E HARTIMIT TË PLANIT

Plani vjetor i gjimnazit "Perikli Ikonomi" Fier për vitin shkollor 2026-2027 mbështetet në:

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, nenet 51-53;
- Udhëzimin e përbashkët nr. 15, datë 18.8.2025 "Për vitin shkollor 2026-2027 në sistemin arsimor parauniversitar";
- Planin afatmesëm të shkollës 2026-2030;
- Akte të tjera nënligjore.

Procesit të planifikimit vjetor 2026-2027 i paraprin dhe i shërben hartimi i raportit vjetor të shkollës për vitin shkollor 2025-2026, analiza e rezultateve të sesionit të parë të Maturës Shtetërore 2026 dhe statistikave të përfundimit të vitit shkollor 2025-2026 (përfundimet e qershorit), përgatitja për plotësimin e Kartës së Performancës 2025-2026, si edhe analiza e gjetjeve dhe rekomandimeve në raportin e vlerësimit të plotë të gjimnazit "Perikli Ikonomi" prej AKAP/ASCAP nr. 2087/5 prot., datë 21.7.2026.

Në datën 31.8.2025 në mbledhjen e këshillit të mësuesve u ngrit grupi i punës për hartimin e planit për vitin shkollor 2026-2027.

Plani si draft ka përfunduar në fund të muajit javën e parë të muajit shtator 2026.

Në datën 8.9.2025 plani i hartuar iu paraqit kryetares së bordit të shkollës dhe u miratua. Ky plan parashikohet të zbatohet prej datës 14.9.2026.

Plani vjetor i shkollës i paraqitet për miratim ZVAP Fier, në përputhje me pikën 6 në nenin 53 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

ANALIZA E GJENDJES

1. Ndjekja e IA-së (përqindja e braktisjes së shkollës, përqindja e mungesave vjetore e të gjithë nxënësve kundrejt të gjitha orëve mësimore).

Nga 426 nxënës në kontingjentin e fillimit të vitit shkollor 2025-2026, deri në përfundim të vitit mësimor u larguan 38 nxënës (8,9% e kontingjentit të fillimvitit shkollor) nga 22 nxënës të larguar një vit më parë (5,2%). Vihet re se largimet janë në rritje, pasi në dy vitet pararendëse ky tregues ka shënuar rritje (4,9% në vitin 2023-2024, 5,2% në vitin 2024-2025), pas një periudhe rënieje të ndjeshme (12% në vitin 2021-2022, 8% në vitin 2022-2023). Ndryshe nga një vit më parë ku 31,8% e nxënësve të larguar emigruan jashtë vendit, këtë vit vetëm dy nxënës nga 38 u larguan për këtë arsye (5% e të larguarve). 5 % e të larguarve janë transferuar në shkolla jashtë ZVAP Fier (2 nxënës në Tiranë, për arsye të ndryshimit të vendbanimit), 8% ose 3 nxënës janë rikthyer në shkollat pranë vendbanimit, dhe 7 të tjerë janë transferuar në shkolla private brenda qytetit (18%). Ky grup i fundit është tregues problematik, pasi konstatohet se nxënësit largohen drejt arsimit privat që u ofron më me lehtësi rezultate më të larta.
Pjesa më e madhe e të larguarve përbëhet nga 25 nxënësit e përjashtuar për mungesa, 66% e të gjithë listës së nxënësve të larguar, ose 5,9% e të gjithë kontingjentit të nxënësve në fillim të vitit shkollor. Duke pasur parasysh se në vitin shkollor 2024-2025 ky grup përbënte 2,4% të të gjithë nxënësve të shkollës (10 nxënës ndër 425 gjithsej), 1,6% në vitin 2023-2024 dhe 0,6% në vitin 2022-2023, rezulton se të përjashtuarit për mungesa janë duke u shtuar ndjeshëm. Duke pasur parasysh tolerancën zero ndaj shkeljes së rregullores, mbylljes së mjediseve të shkollës me qëllim rritjen e sigurisë dhe eliminimit të mundësisë për t'iu shmangur pasqyrimit të mungesave në sistem, kjo rënie e treguesit ishte e pritshme, megjithëse duhet ndaluar.
Gjatë vitit shkollor 2025-2026 nxënësit kanë munguar mesatarisht në 2,36% të orëve mësimore (10573 orë ndër 447072 gjithsej). Krahasuar me 2,45% të orëve mësimore në vitin shkollor 2024-2025 ky tregues është në përmirësim të lehtë, por jo në nivelet e dy viteve më parë (1,39%).
Pavarësisht se shifrat tregojnë tendencë negative, ende ky tregues është nën kontroll, duke pasur parasysh se vijon forcimi i disiplinës në evidentimin e mungesave në sistemin SMIP.

Anë e fortë:
Zbatimi me rreptësi i rregullave për hyrje-daljet në mjediset e shkollës, i masave disiplinore për nxënësit që mungojnë pa arsye dhe ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë për evidentimin e mungesave kanë efekt në ndërgjegjësimin e nxënësve për frekuentimin e rregullt të shkollës.

Anë të dobëta:
Mungesë ndërgjegjësimi i një pjese të nxënësve të rinj dhe i prindërve të tyre mbi rregullat e qëndrimit në shkollë. Tërheqja e nxënësve prej shkollave private që u ofrojnë standarde më të ulëta për rezultate më të larta.

2. Aspekti social

Gjimnazi “Perikli Ikonomi” mirëpret nxënës nga familje me nivele të ndryshme arsimimi dhe ekonomike, nga qyteti dhe zona rurale, nga familje të shtresave të margjinalizuara, në kushte të pafavorshme sociale dhe nga kultura të ndryshme. Në hartën sociale 2025-2026 rezultojnë vetëm 5 nxënës nga familje në skemën e ndihmës ekonomike, që përbëjnë 1,2% të kontingjentit, tregues më i ulët se një vit më parë (në vitin 2024-2025 ishin 16 nxënës, ose 4% e kontingjentit). 14 nxënës ishin jetimë me një prind, dyfishi i numrit të një viti më parë. 16 nxënës ose 3,8% e kontingjentit vinin nga familje me prindër të divorcuar (pak më e lartë se një vit më parë). Pavarësisht riskut, nuk janë evidentuar problematika tipike prej nxënësve të këtyre kategorive, falë edhe përkujdesjes nga ana e mësuesve dhe punës efektive prej oficeres së sigurisë dhe psikologes së shkollës.

Numri i prindërve/kujdestarëve ligjorë të nxënësve me nivel arsimor bazë ose nën nivelin bazë (me arsim 8/9-vjeçar ose më pak) ishte pak më i ulët se një vit më parë; 36% nga 40% në hartën sociale të vitit 2024-2025 dhe 48% në vitin shkollor 2023-2024). Përqindja e prindërve me arsm të mesëm mbetet 47%, sa në vitin 2024-2025, ose 2% më shumë se në vitin 2023-2024 dhe në rritje. Gjithashtu në rritje të dukshme e të qëndrueshme ishte edhe numri i prindërve me arsim të lartë; 17% në vitin e kaluar, 13% në vitin 2024-2025 dhe 7% e prindërve në vitin 2023-2024. Një përqindje më e lartë, në rritje konstante, e prindërve me arsim të universitar, tregon edhe interesin e shtuar ndaj kësaj shkolle nga ana e prindërve me pretendime për rezultate të larta të fëmijëve të tyre. Megjithatë, përsëri vihet re se prindërit me nivel arsimor të ulët dhe të mesëm shfaqin indiferencë ndaj aktiviteteve të shkollës, mosangazhim në vendimmarrjet e organizmave të saj dhe interes të dobët për frekuentimin e rregullt të fëmijëve të tyre. Në fillim të vitit të kaluar shkollor, në hartën sociale të shkollës u evidentuan 33 nxënës me talent në fusha të caktuara të artit, sportit, me një përmirësim të lehtë nga një vit më parë (29 nxënës). Ky kontingjent pritet të rritet ndjeshëm me përfshirjen në klubet e programit “Pas Shkolle” që do të hapen në fusha të tilla si teatri, kërcimi, arti pamor apo zejet tradicionale. Nxënës me vështirësi në të nxënë nuk janë evidentuar edhe këtë vit (2025-2026) nga shërbimi psikosocial, por 8 nxënës, ose 1,9% e nxënësve është konsideruar nga shërbimi psikosocial si “shumë të dobët në mësime” (një vit më parë ishin 5%). Në vitin 2025-2026 në gjimnazin “Perikli Ikonomi” vijuan arsimimin 4 nxënës nga komuniteti rom (5 nxënës romë frekuentuan një vit më parë), si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme për të afruar nxënës të tjerë nga komuniteti rom, prej shkollave 9-vjeçare të afërta, por që jo gjithmonë kanë rezultuar të suksesshme. Dy prej nxënësve romë ishin maturantë, por nuk arritën të diplomoheshin, pasi nuk u paraqitën në provimet e Maturës Shtetërore, pa dhënë ndonjë arsye.

Anë e fortë:
Shkolla është realisht institucion arsimor gjithëpërfshirës. Nuk evidentohen paragjykime sociale në nivele penguese. Nuk ka numër të lartë të nxënësve të kategorive problematike.

Anë e dobët:
Vihet re indiferencë nga prindërit e nxënësve që nuk frekuentojnë rregullisht.

3. Rezultatet e nxënësve

Në përfundim të vitit mësimor 2025-2026, rezulton se nota mesatare e nxënësve të gjithë shkollës për vitin shkollor është 7,65, pak më e lartë se nota mesatare 7,25 e regjistruar në qershor 2025. Kjo e rikthen shkollën në tendencën disavjeçare të rritjes së notës mesatare, megjithëse nuk u arrit plotësisht objekti i vendosur.
Kalueshmëria e nxënësve të shkollës për këtë vit shkollor (statistikat e qershorit 2026) ishte 91,49%, më e lartë se e një viti më parë (87,93%). Duke pasur parasysh se kalueshmëria në qershor 2025 ishte 94,4%, ndërsa një vit më parë ishte 93,6%, edhe për këtë tregues shënohet rikthim në drejtimin e rritjes së cilësisë, megjithëse jo në objektivin e synuar prej 94%.
Pas provimeve të klasës në sesionin e dytë, me kalimin në klasën pasardhëse XI dhe XII, si edhe të 3 maturantëve kalues klase në vjeshtë, kalueshmëria e vitit shkollor arriti në nivelin 98,71% nga 92% një vit më parë.
Nga analiza mbeten të njëjtat arsye mbi të cilat evidentohen edhe pikat e forta dhe të dobëta.

Anë e fortë:
Janë evidentuar pikat e dobëta si shkak për mosrealizimet e vitit të kaluar dhe ka mësues të aftë e të përkushtuar për të vijuar në drejtimin e përmirësimit të cilësisë së shkollës.

Anë e dobët:
Kalueshmëria dhe nota mesatare në fund të vitit mësimor, për shkak të mungesave në lëndë të caktuara, ndryshimeve në personelin mësimdhënës, është ende më e ulët se objektivi i vendosur për një shkollë cilësore.

4. Treguesit për të cilët shkolla ka arritjen më të mirë dhe më të ulët në renditje për institucionet arsimore të suksesshme në nivel ZVA-je.

Ende nuk është publikuar renditja e institucioneve arsimore në shkallë ZVA-je, në bazë të treguesve të kartës së performancës.

5. Etika dhe sjellja

Gjatë vitit shkollor 2025-2026 ka pasur 4 raste ankesash të paraqitura për shqyrtim në komisionin e etikës dhe sjelljes, nga të cilat 2 raste janë dërguar për masë në komisionin e disiplinës. Komisioni i disiplinës ka dhën për një nxënës masë disiplinore "paralajmërim për ulejn e notës në sjellje".
U arrit që të zbatohej plotësisht rregullorja për lëvizjen e nxënësve në mjediset e shkollës dhe u ndalua me sukses dalja e pakontrolluar e nxënësve, nëpërmjet masave të shtuara të kontrollit të mjediseve, të pasqyrimit të mungesave apo largimeve pa arsye të nxënësve.

Anë e fortë:
Shkolla ka një oficere sigurie aktive gjatë kohës së funksionimit të shkollës, e cila ka bashkëpunim të plotë me mësuesit dhe strukturat e policisë.

Anë e dobët:

Nuk evidentohet problematikë.

6. Arritjet në provimet kombëtare dhe në testimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në sesionin e parë në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore 2026 u shënua rënie në treguesit e cilësisë krahasuar me shifrat e MSH 2024. Në provimet e detyruara kalueshmëria, sipas përllogaritjes së kartës së performancës rezulton pak më e lartë se një vit më parë, 96,3% nga 93,64%, një përmirësim që ende nuk është në nivelin e 99,49% në KPSH 2024 (99,49%) apo të KPSH 2023 (99,25%).

Në përfundim të sesionit të parë të MSH 2026 kalueshmëria rezulton 79,84% që vijon të jetë më e ulët se niveli prej 82% i MSH 2025 apo 95% i MSH 2024.
Në këtë analizë mbahet parasysh se nxënësit mbetës në provime të ndryshme janë të ndryshëm. Përfshihen në analizë edhe nxënësit që nuk morën pjesë në provim.

Në sesionin e parë në provimin e gjuhës shqipe dhe letërsisë kaluan 96% e maturantëve, krahasuar me 94,85% në maturën e kaluar. Nota mesatare në provimin e detyruar të gjuhës shqipe dhe letërsisë rezultoi 7,1 më e ulët se në dy vitet e mëparshme (7,34 në MSH 2025 dhe 7,6 në MSH 2024), duke dëshmuar për një tendencë rënieje, që duhet ndalur. Në provimin e matematikës kalueshmëria në qershor ishte 96,77%, më e lartë se treguesi prej 86,8%, i një viti më parë. Nota mesatare në provimin e matematikës ishte 5,51, megjithëse pak më e lartë se një vit më parë (5,31), përsëri është dëshmi e nivelit të pamjaftueshëm të punës dhe cilësisë. Në MSH 2024 dhe MSH 2023 ky nivel ka qenë respektivisht 7,29 dhe 6,4. Ndërsa në provimin e gjuhës angleze në qershor kaluan 96,12% e maturantëve, me rënie prej notës mesatare 99,3% të një viti më parë, por ende më i lartë se në MSH 2024 (98,5%). Nota mesatare në provimin e gjuhës së huaj ishte 7,19, pak më e ulët se mesatarja 7,71 e një viti më parë, diktuar edhe nga notat e maturantëve mbetës.

Në provimin me zgjedhje kalueshmëria është në nivelin 96,6% (4 maturantë mbetës ndër 119 maturantë që u paraqitën në provim). Edhe në këtë provim u shënua rënie nga një vit më parë (98,5%), ndërsa në MSH 2024 ishte në nivelin 100%. Nota mesatare në provimet me zgjedhje ishte 6,91, në tendencë rënie krahasuar me mesataren 7,5 në MSH 2025 dhe 7,76 në MSH 2024.

Shkaqet lidhen, si edhe në treguesit e kalueshmërisë dhe cilësisë në përgjithësi në të gjitha klasat, me ndryshimet në personelin mësimdhënës të shkollës, për shkak të largimit të disa mësuesve, ose punës me ngarkesë të pjesshme në këtë shkollë. Këtyre arsyeve iu shtohen edhe mospërgatitja e maturantëve për situata problematike që lidhen me administrimin, si edhe mbetja apo mungesat e maturantëve të ndryshëm në provime të ndryshme.

Gjatë vitit shkollor 2025-2026 shkolla nuk është përfshirë në testime kombëtare apo ndërkombëtare.

Anë e fortë:

Ka mundësi reale për përmirësim të cilësisë së shkollës në treguesin e kalueshmërisë dhe të notës mesatare vjetore në tërësi në provimet e maturës, pasi personeli mësimdhënës është i motivuar për ndryshim.

Anë e dobët:
Ka rënie të cilësisë në provimet e MSH, ku evidentohet mangësi në përgatitjen e maturantëve për plotësimin e testit.

7. Mësuesit: përqindja e orëve mësimore të munguara nga mësuesit kundrejt të gjitha orëve mësimore, numri i krediteve të punonjësve arsimorë.

Gjatë vitit mësimor 2025-2026 nuk ka pasur mungesa të mësuesve brenda një dite pune. Gjatë vitit shkollor ka pasur 18 ditë mungesa nga mësuesit, shumë më pak se 93 ditë mungesa të një viti më parë. Këto mungesa llogariten në 0,3% të totalit të ditëve të punës nga 1,69% e një viti më parë (5490 ditë pune, për 30 mësues, duke marrë parasysh se dy prej tyre kanë pasur ½ e normës mësimore në këtë shkollë), ose 0,6 ditë pune për mësues, (3,1 ditë pune mungesë për çdo mësues një vit më parë). Krahasuar me një vit më parë përmirësimi është i ndjeshëm dhe i qëndrueshëm, pasi edhe në vitin 2023-2024 mungesat e mësuesve në raport me totalin e kohës së punës kanë rënie (1,93%). Mësuesit kanë munguar për arsye shëndetësore, vërtetuar me raport mjekësor. Një mësues i edukimit fizik është lejuar të marrë pjesë në veprimtari sportive ndërkombëtare, vërtetuar nga federata sportive, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Në vitin shkollor 2025-2026 tre mësues kaluan testin e kualifikimit profesional me rezultatin "Shkëlqyeshëm" duke fituar shkallën e kualifikimit "Mësues Specialist" (1) dhe "Mësues Mjeshtër" (2). Dy mësues të tjerë fituan shkallën e kualifikimit "Mësues Mjeshtër" me rezultatin "Shumë mirë". Si edhe një vit më parë, rezultatet në kualifikimin e mësuesve kanë qenë "Shumë mirë" ose "Shkëlqyeshëm". 26 mësues nga 30 ndoqën të paktën një program trajnimi gjatë vitit shkollor 2025-2026, duke fituar një kredit, pa ndryshim nga një vit më parë.

Anë e fortë:
Nivel i lartë i disiplinës në punë dhe angazhimit të personelit. Përgatitje profesionale e lartë e mësuesve.

Anë e dobët:
Ka mësues që shfaqin probleme shëndetësore.

8. Pjesëmarrja në projekte me OJF, në olimpiada, konkurse, gara.

Edhe gjatë vitit shkollor 2025-2026 nxënësit tanë nuk morën pjesë masivisht në fazën e parë dhe të dytë të olimpiadave kombëtare, ku nuk pati edhe fitues të çmimeve që ndan ZVAP Fier nga shkolla jonë.
Ndërsa në aktivitete të tjera të organizuara midis shkollave të arsimit të mesëm të lartë nga Bashkia Fier në bashkëpunim me ZVAP Fier, pjesëmarrja e nxënësve të gjimnazit "Perikli Ikonomi" ka qenë e qëndrueshme, duke ruajtur ritmin e fitoreve që renditen në vijim:

Nr.	Aktiviteti	Fituesi	Vendi
1	Krosi i vjeshtës 2025, femra	A.H., klasa XI	2
2	Krosi i vjeshtës 2025, femra	A.C., klasa XI	3
3	Krosi i vjeshtës 2025, femra	A.Ç., klasa XII	2
4	Krosi i vjeshtës 2025, femra	Xh.R., klasa XII	3
5	Krosi i vjeshtës 2025, meshkuj	A.Xh., klasa XII	1
6	Krosi i vjeshtës 2025, meshkuj	A.V., klasa XII	2
7	Kampionati i volejbollit, meshkuj	Skuadra	1
8	Kampionati i volejbollit, femra	Skuadra	2
9	Kampionati i basketbollit, femra	Skuadra	1
10	Kampionati i basketbollit, meshkuj	Skuadra	2
11	Kampionati i futbollit, djem	Skuadra	2
12	Kampionati i futbollit, djem, në nivel kombëtar	Skuadra	2
13	Festivali i teatrit "RinFestë Teatër 2026"	Grupi	Çmimi "Fatos Sela"
14	Çmimi "Fatos Sela" në aktivitetin "RinFestë Teatër 2026"	R.A.	Aktorja më e mirë joprotagoniste
15	Festivali i shkencës	Skuadra	2

Ky tregues shënon ngritje me 1 çmim më shumë të fituar për llogaritje në Kartën e Performancës, që vlerësohen me 45 pikë në kartën e performancës së vitit 2025-2026 (nga 36 pikë në kartën e performancës 2024-2025).

Gjatë vitit shkollor 2025-2026 ka vijuar bashkëpunimi me KOKSH-in për projektin “Ekipet sportive në shkolla” me krijimin dhe aktivizimin e dy ekipeve të basketbollit.

Në Festivalin e Shkencës 2026, shkolla jonë ka zënë vendin e dytë në nivel ZVAP-je me dy projekte në fushën e teknologjisë, të prezantuara nga një ekip i shkëlqyer nxënësish nën drejtimin e mësueses së fizikës.

Anë e fortë:
Nxënësit e shkollës sonë ruajnë nivelin e sukseseve në aktivitetet sportive. Ka arritje në

Anë e dobët:
Ende nuk është konsoliduar puna e diferencuar me talentet nëpërmjet klubeve shkencore.

9. Qëndrimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar nga IA-ja.

Për vlerësimin e shkollave, ZVA Fier ka zhvilluar në muajin maj 2026 pyetësorët e kartës së performancës me nxënës, prindër dhe mësues të shkollës.
Perceptimi i nxënësve ndaj cilësisë së shërbimit arsimor të gjimnazit tonë rezulton të jetë si vijon:

- Në total 92% e nxënësve shprehen se “janë plotësisht dakord” dhe 8% shprehen “dakord” mbi cilësinë e shkollës (99,7% në maj 2025 dhe 97,4% në maj 2024). Ky nivel, pavarësisht një rezerve

prej disa nxënësve, gjithsesi dëshmon se nxënësit e vlerësojnë potencialin e shkollës për të qenë edhe më e suksesshme.

- 100% e nxënësve shprehen plotësisht dakord që t'ua rekomandojnë shokëve këtë shkollë për të vazhduar studimet, ose që ndihen krenarë që janë nxënës të kësaj shkolle.
- 100% e nxënësve shprehen se janë plotësisht dakord me pohimin "Drejtoria na njofton për çdo rregull apo ndryshim të rëndësishëm në shkollë".
- Vetëm dy nxënës janë shprehur "dakord" me pohimin "Unë ndihem i sigurt dhe i mbrojtur brenda mjediseve të shkollës sime", ndërsa të tjerët janë plotësisht dakord.
- Por 63% e nxënësve janë shprehur thjesht "jam dakord" me pohimin "Shkolla ime ka kushte të mira fizike (ngrohje, ujë, higjienë dhe ndriçim)".
- 100% e nxënësve janë shprehur "plotësisht dakord" me pohimet "Mësuesit na mësojnë si të përdorim internetin dhe Inteligjencën Artificiale në mënyrë të sigurt", "Gjatë orës së mësimit, mësuesi/ja më nxit të shpreh lirshëm mendimin tim", "Kur kam pyetje apo nuk kuptoj diçka, mësuesit më sqarojnë me durim", "Shkolla më ndihmon të zbuloj dhe të zhvilloj talentet e mia të veçanta", "Mësuesit tregojnë respekt dhe kujdesen për shqetësimet tona emocionale", "Kur kam një problem personal, mund të bisedoj lirisht me psikologun ose punonjësin social", "Shkolla na mëson se si të mbrojmë shëndetin nga duhani, droga dhe varësinë nga bota digjitale" dhe "Në shkollë ne mësojmë të respektojmë shokët që janë ndryshe nga ne".
- Asnjë nxënës nuk është shprehur "nuk jam dakord" apo "pjesërisht dakord" lidhur me pohimet në pyetësor.

Anë e fortë:
Shumica e nxënësve mendojnë pozitivisht për personelin mësimor, cilësinë dhe sigurinë në shkollë.

Anë e dobët:
Një pjesë e nxënësve shprehen jo entuziastë me të drejtë për infrastrukturën e shkollës (kryesisht mungesën e ngrohjes).

SYNIMI

Synimi ynë lidhet me një prej përparësive në planin afatmesëm të shkollës 2026-2030: "*Rritja e cilësisë së të nxënit dhe përmirësimi i rezultateve të maturës*".

Për vitin shkollor 2026-2027 synimi ynë do të vijojë të jetë:

"Konsolidimi i imazhit pozitiv për shkollën tonë nëpërmjet qëndrueshmërisë dhe rritjes cilësore, për t'u kthyer në shkollën ku nxënësit realizojnë ëndrrat dhe dëshirat".

Mbështetur në të dyja përparësitë e planit afatmesëm, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën, si dhe në analizën e vitit shkollor 2025-2026, diferenca në notë midis vlerësimit vjetor në të gjitha klasat dhe vlerësimit të jashtëm (provimeve të MSH) ul interesin e nxënësve për të ndjekur gjimnazin tonë. Gjithashtu kjo është një nga arsyet e regjistrimeve në rënie në klasën X dhe largimeve drejt shkollave private. Kalueshmëria dhe rezultatet jo të kënaqshme dhe të luhatshme në provimet e maturës do të marrin një vëmendje të veçantë me qëllim përmirësimin e tyre në fund të vitit shkollor 2026-2027.

Për vitin shkollor 2026-2027 përcaktojmë:

OBJEKTIVAT

e mëposhtme:

1. Në përfundim të vitit mësimor (qershor 2027) niveli i kalueshmërisë së shkollës të jetë jo më i ulët se 93%, nga niveli prej 91,5% i vitit të kaluar.
   Në këtë tregues nuk llogariten rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.

2. Në përfundim të sesionit të parë të Maturës Shtetërore (qershor 2027) përqindja e maturantëve me diferencë note në provimet e detyruara, krahasuar me notën vjetore, të ulet në 15% nga niveli prej 25,5% në vitin e kaluar shkollor.

3. Në përfundim të sesionit të parë të Maturës Shtetërore 2027 përqindja e maturantëve kalues të rritet në 91% nga niveli prej 79,8% (103 maturantë nga 129) në sesionin e parë të MSH 2026.

VEPRIMTARITË PËR VËZHGIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

Për realizimin e objektivave planifikohen këto veprimtari:

Objektivi	Nr.	Veprimtaria	Ngarkohet	Produkti	Afati
1. Në përfundim të vitit mësimor (qershor 2027) niveli i kalueshmërisë së shkollës të jetë jo më i ulët se 93%, nga niveli prej 91,5% i vitit të kaluar. *Në këtë tregues nuk llogariten rezultatet e provimeve të Maturës Shtetërore.*	1	Analizë për të përcaktuar lëndët ku ka pasur dobësi	Secili mësues	Raport	Nëntor 2026
	2	Hartimi i një plani ndërhyrjeje për ndryshimin e gjendjes në pikat e dobëta të konstatuara	Drejtoria	Plan	Dhjetor 2026
	3	Takime me prindër të nxënësve që rrezikojnë të mbeten në klasë	Secili mësues kujdestar	Procesverbal	Shkurt 2027
	4	Raportim në drejtori për nivelin e arritjeve të nxënësve të rrezikuar për të mbetur në klasë	Secili mësues kujdestar	Raport	Mars 2027
	5	Analizë e numrit të mungesave 1-3 orëshe, si një shkak për të mbetur në klasë	Nëndrejtori	Raport	Prill 2027
	6	Takim pune me mësuesit e lëndëve ku parashikohet kalueshmëri e ulët	Drejtoria	Procesverbal	Maj 2027
2. Në përfundim të sesionit të parë të Maturës Shtetërore (qershor 2027) përqindja e maturantëve me diferencë note	1	Evidentimi i diferencave në vlerësimet e vazhduara krahasuar me notat e testimeve	Mësuesit e gjuhës shqipe e letërsië, matematikës dhe gjuhës angleze në klasat XII	Evidencë për çdo maturant	Dhjetor 2026
		Konsultime me maturantët për lëndët e provimeve të detyruara			Janar 2027

Objektivi	Nr.	Veprimtaria	Ngarkohet	Produkti	Afati
në provimet e detyruara, krahasuar me notën vjetore, të ulet në 15% nga niveli prej 25,53% në vitin e kaluar shkollor		Analizë e diferencave pas paratestit në secilën lëndë të provimeve të detyruara		Raport	Prill – maj 2027
3. Në përfundim të sesionit të parë të Maturës Shtetërore 2027 përqindja e maturantëve kalues të rritet në 91% nga niveli prej 79,8% (103 maturantë nga 129) në sesionin e parë të MSH 2026	1	Analizë e notave mesatare të arritura në përfundim të periudhës së parë dhe të dytë për secilin maturant	Mësuesit kujdestarë të klasave XII	Raport	Dhjetor 2026 Prill 2027
	2	Seanca orientuese me maturantët mbi përcaktimin e lëndës me zgjedhje në provimin e maturës, njohja me vështirësitë e lëndës, aftësitë e shfaqura dhe nevojat e secilit prej tyre për të arritur rezultatin e kërkuar	Mësuesit e lëndëve me zgjedhje (fizikë, kimi, biologji, ekonomi, histori, psikologji, etj.)	Plan	Janar 2027
	3	Plan ndërhyrjeje për sigurimin e kalueshmërisë për maturantët e nivelit të notave 4 – 5 – 6	Mësuesit e gjuhës shqipe e letërsisë, matematikës	Plan	Shkurt 2027
	4	Konsultime me maturantët për të gjitha lëndët e provimeve të maturës	Mësuesit e lëndëve provim mature	Plan	shkurt-maj 2027

VEPRIMTARITË PËR VËZHGIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

Për vëzhgimin e zbatimit të planit gjatë vitit shkollor 2026-2027 ngarkohet grupi i punës

Nr.	Veprimtaria vëzhguese	Afati
1	Relacion për realizimin e veprimtarive mbi objektivat e planit	Dhjetor 2026 Mars 2027 Maj 2027
2	Pjesëmarrje në seancat orientuese, konsultimet, takimet e punës	Sipas grafikut, njoftohet nga drejtoria
3	Pyetësor me maturantët me arritje mesatare mbi nivelin e asistencës që marrin nga mësuesit për eliminimin e vështirësive që kanë për arritjen e rezultateve më të larta	Prill 2027
4	Shqyrtim i rezultateve të paraprovimeve në lëndët e maturës	Maj 2027

BUXHETI

Nuk parashikohet buxhet për realizimin e objektivave të planit vjetor 2026-2027.